

**URDHËR**  
**Nr. 168, datë 27.4.2022**

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË PËRKTHYESIT ZYRTAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 12, pika 1, shkronja “e” të ligjit nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Kodit të Etikës së Përkthyesit Zyrtar sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
  2. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë dhe Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
  3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Ulsi Manja**

**KODI I ETIKËS SË PËRKTHYESIT ZYRTAR**

**Preambulë**

Për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e çdo personi për t’u mbrojtur dhe përdorur gjuhën që ai kupton gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe legjislacionin në fuqi;

Duke njohur rëndësinë dhe nevojën e përkthimit të një teksti, dokumenti zyrtar ose të një akti normativ të miratuar në Republikën e Shqipërisë, të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është vend anëtar ose ka filluar procedurat e anëtarësimit në të;

Duke marrë në konsideratë rregullimin për herë të parë të profesionit të përkthyesit zyrtar me ligj të veçantë;

Me qëllim ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar në përputhje me ligjin dhe standardet më të larta etike dhe profesionale dhe krijimin e një shërbimi përkthimi cilësor, në shërbim dhe mbrojtje të interesave të çdo qytetari shqiptarë dhe të huaj, si dhe të shtetit shqiptar;

Për të vendosur dhe zbatuar standardet më të larta të etikës dhe sjelljes profesionale në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e përkthimit, që garantojnë ushtrimin e profesionit dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor;

Vendosa miratimin e Kodit të Etikës së përkthyesit zyrtar sipas rregullave të mëposhtme:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Kod ka si qëllim të përcaktojë:

a) parimet, standardet dhe rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale në ushtrimin e profesionit dhe veprimtarisë së përkthimit zyrtar, në shërbim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe personave juridikë, publik apo privat, shqiptarë dhe të huaj, si dhe të shtetit shqiptar;

b) të drejtat dhe detyrimet e përkthyesit zyrtarë në marrëdhënie me klientët, autoritetet publike dhe kolegët.

## Neni 2 **Baza ligjore**

1. Kodi i Etikës së Përkthyesit Zyrtar bazohet në ligjin nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (më tej “ligji”).

2. Dispozitat e këtij Kodi mbështesin, respektojnë dhe sigurojnë pajtueshmërinë me normat që rregullojnë profesionin dhe veprimtarinë e përkthyesit zyrtar të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ato interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të synojnë përmbushjen sa më efektive të qëllimit për të vendosur standarde sa më të larta të etikës profesionale në ushtrimin e profesionit.

## Neni 3 **Fusha e zbatimit**

Kodi zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është i detyrueshëm për çdo përkthyes zyrtar që kryen përkthim zyrtar në territorin e saj.

## Neni 4 **Statusi i përkthyesit zyrtar**

1. Përkthyesi zyrtar është personi fizik i certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë për të kryer përkthimin zyrtar të teksteve dhe përkthimin me gojë sipas ligjit.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përkthyesi zyrtar i nënshtrohet vetëm legjislacionit në fuqi dhe akteve të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

## Neni 5 **Parimet e përgjithshme në ushtrimin e profesionit**

Përkthyesi zyrtar gjatë ushtrimit të profesionit të tij udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, të etikës, të integritetit, besnikërisë ndaj tekstit burimor, paanshmërisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, si dhe të mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë duke zbatuar standardet më të larta etike dhe profesionale.

## Neni 6 **Parimi i profesionalizmit**

1. Për të garantuar respektimin e parimit të profesionalizmit, përkthyesi:

a) vepron me përkushtim dhe gatishmëri për të kryer një përkthim cilësor duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale;

b) nuk merr përsipër kryerjen e një përkthimi ose heq dorë prej tij kur nuk zotëron, apo arrin në përfundimin se nuk zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e tij, me përjashtim të rastit kur bashkëpunon me një përkthyes zyrtar tjetër dhe klienti ka shprehur pëlqimin paraprak për këtë bashkëpunim;

c) kërkon të gjithë informacionin që i nevojitet për kryerjen e përkthimit përpara se të fillojë punën, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) njofton menjëherë klientin ose institucionin publik për çdo rrethanë apo shkak që mund të sjellë si pasojë cenimin e cilësisë së përkthimit;

d) kryen përkthimin brenda afatit të përcaktuar ose brenda një afati të arsyeshëm kur ai nuk është përcaktuar, si dhe njofton klientin për çdo shkak apo rrethana që mund të cenojë kryerjen e tij brenda afatit;

2. Për të arritur një shkallë sa më të lartë profesionalizmi, përkthyesi:

a) përmirëson në mënyrë të vazhdueshme kualifikimet profesionale në fushën e përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj dhe anasjelltas, si dhe merr pjesë në trajnime të organizuara për këtë qëllim nga ministria, institucionet e arsimit të lartë apo shoqatat;

b) ndërmer në mënyrë të vazhdueshme hapa të arsyeshëm për të ruajtur e zhvilluar njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për ushtrimin e profesionit;

c) informohet në mënyrë të vazhdueshme me risitë dhe zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me veprimtarinë e përkthimit dhe profesionin e përkthyesit zyrtar;

ç) bashkëpunon dhe ndërvepron me kolegët për shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira profesionale.

## Neni 7

### **Parimi i etikës dhe integritetit**

Për të garantuar respektimin e parimit të etikës dhe integritetit, përkthyesi zyrtar:

a) merr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur dhe forcuar dinjitetin dhe standardet e profesionit;

b) ushtron veprimtarinë dhe profesionin në mënyrë të pavarur, duke shmangur çfarëdolloj forme interesi personal apo financiar që mund të ndikojë në kryerjen e përkthimit;

c) shmang çdo sjellje të rëndë e të papërshtatshme etike dhe morale që cenon besimin e publikut në shërbimin e përkthimit zyrtar;

ç) zbaton standardet më të larta të integritetit, sjelljes etike, morale dhe profesionale, duke përfshirë edhe sjelljen kur ai nuk është duke ushtruar veprimtarinë si përkthyes zyrtar;

d) nuk merr përsipër kryerjen e një përkthimi ose heq dorë prej tij kur arrin në përfundimin se një sjellje apo veprimtari e tij do të përbënte shkak për shkeljen e ligjit dhe këtij Kodi;

dh) nuk kërkon ose pranon, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në pavarësinë e kryerjes së përkthimit, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për kryerjen e përkthimit, me përjashtim të tarifës së përcaktuar për kryerjen e shërbimit;

e) kur i janë ofruar përfitimet sipas shkronjës “dh” të këtij neni, i refuzon ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, ia kthen mbrapsht ofruesit ose, në pamundësi, i dorëzon zyrtarisht dhe menjëherë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe në rast se ofrimi lidhet me kryerjen e një vepre penale, bën kallëzim pranë organit të ndjekjes penale;

ë) nuk lejon me vetëdije anëtarët e familjes apo persona të tjerë që të kërkojnë ose pranojnë përfitimet sipas shkronjës “dh” të këtij neni, që vijnë për shkak të ushtrimit të profesionit;

f) shmang përdorimin e paligjshëm të statusit të përkthyesit zyrtar, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;

g) shmang çdo sjellje apo veprim që rrit në mënyrë të pajustificuar masën e shpërblimit për kryerjen e përkthimit;

gj) kur merr dijeni, njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë mbi çdo sjellje apo veprimtari të kryer nga ana e përkthyesve të tjerë, në kundërshtim me parashikimet e këtij Kodi.

## Neni 8

## **Parimi i besnikërisë ndaj tekstit burimor**

Për të garantuar respektimin e parimit të besnikërisë ndaj tekstit burimor, përkthyesi zyrtar:

- a) përdor të gjitha njohuritë dhe aftësitë e tij personale për të kryer një përkthim të plotë dhe cilësor, që i qëndron besnik përmbajtjes dhe qëllimit të tekstit dhe mesazhit burimor;
- b) përkthen në mënyrë të plotë, të qartë, të pastër dhe me saktësinë më të madhe të mundshme tekstin dhe mesazhin në gjuhën e synuar, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalive dhe përmbajtjen e tij;
- c) përkthen në gjuhë neutrale dhe ruan tekstin dhe mesazhin burimor nga shtrembërimi përmes ndryshimit, shtimit, heqjes, shpjegimit apo parafrazimit të fjalëve, si dhe përdor vetën e parë gjatë përkthimit me gojë;
- ç) në raste përjashtimore dhe kur është e nevojshme, përshtat dhe shpjegon koncepte komplekse apo terma të gjuhës së burimit që nuk kanë një përkthim ekuivalent ose të përshtatshëm në gjuhën e synuar ose kur ekuivalenti i tyre mund të mos jetë i kuptueshëm dhe kërkon shpjegim;
- d) përkthen shprehjet që kanë të bëjnë me kulturën e gjuhës së burimit duke përdorur shprehje analoge të gjuhës së synuar që kanë të njëjtin kuptim dhe ruan ato shprehje të cilat nuk kanë përkthim të përshtatshëm në gjuhën e synuar;
- dh) përkthen çdo fjalë dhe shprehje, duke përfshirë edhe shprehjet vulgare, nënçmuese, fyerjet dhe përdor çdo aspekt të komunikimit si toni i zërit dhe emocionet e folësit, të cilat mund të lehtësojnë kuptimin e tekstit dhe mesazhit të përçar;
- e) përdor të gjithë elementët e tekstit dhe mesazhit burimor duke përdorur format sintaksore dhe semantike të gjuhës;
- ë) njofton menjëherë çdo pasaktësi në përkthim duke përdorur shprehjen “Përkthyesi njofton korrigjimin e një pasaktësie” dhe më pas korrigjon pasaktësinë;
- g) njofton dhe kërkon përsëritje, riformulim ose shpjegim menjëherë sapo konstaton vështirësi ose paqartësi në të kuptuarit e tekstit ose mesazhit e përçar duke përdorur shprehjen “Përkthyesi kërkon përsëritjen/riformulim/shpjegimin e ...”;
- gj) kur është rasti, merr në konsideratë dhe reflekton komentet dhe sugjerimet e strukturës përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me cilësinë e përkthimit ose pasaktësisë e tij.

### **Neni 9**

## **Parimi i paanshmërisë**

Për të garantuar paanshmërinë gjatë ushtrimit të profesionit, përkthyesi zyrtar:

- a) nuk merr përsipër kryerjen e një përkthimi ose heq dorë në rast se e ka filluar atë, menjëherë pasi merr dijeni se gjendet në rastet papajtueshmërisë të parashikuara në ligj;
- b) njofton autoritetet publike ose organin procedues në mënyrë të plotë dhe të argumentuar për çdo rast të papajtueshmërisë, si dhe merr masat për të shmangur situata që në mënyrë të arsyeshme mund të çojnë në konflikt interesi;
- c) nuk jep udhëzime ose këshilla juridike apo të çdo natyre tjetër, pavarësisht nëse i kërkojnë ose jo;
- ç) nuk e referon klientin tek asnjë person tjetër që ushtron profesione të tjera, pa i bërë të ditur fillimisht nëse ka ose jo një interes personal apo financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- d) ruan paanshmërinë ndërmjet palëve apo personave të tjerë gjatë përkthimit dhe shmang çdo lloj shprehje apo veprimi i cili mund të ndikojë në qëndrimin e lexuesve të tekstit të përkthyer apo të dëgjuesve;
- dh) nuk paragjykon dhe shmang çdo sjellje, shprehje mendimi, koment apo veprim, të kërkuar ose jo, që mund të interpretohet si shprehje e njëanshmërisë së tij ndaj autorit të tekstit burimor, lexuesve të tekstit që përkthen, si dhe dëgjuesve;

e) nuk merr përsipër kryerjen e një përkthimi ose heq dorë prej tij në rast se nuk mund të kryejë përkthimin në mënyrë të paanshme për shkak të pikëpamjeve apo besimeve personale.

#### Neni 10

### **Parimi i konfidencialitetit të të dhënave**

1. Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidencialitetit të të dhënave për të cilat përkthyesi është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat ose dokumentet e vëna në dispozicion për përkthim, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor, është një e drejtë, detyrim dhe garanci për përkthyesin.

2. Për të garantuar ruajtjen e sekretit profesional dhe konfidencialitetit të të dhënave, përkthyesi zyrtar:

- a) zbaton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) nuk përhap në çfarëdolloj forme të dhënat për të cilat është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat ose dokumentet e vëna në dispozicion për përkthim nga klienti i tij ose të marrë prej tij, rreth këtij klienti ose të tjerëve, gjatë dhe pas kryerjes së përkthimit, me përjashtim të rasteve kur klienti ka shprehur pëlqimin ose të dhënat janë bërë publike;
- c) merr të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe sigurimin e të gjithë informacionit apo dokumentacionit të dhënë nga klienti i tij ose të marrë prej tij, rreth këtij klienti ose të tjerëve, gjatë dhe pas kryerjes së përkthimit;
- ç) merr të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e sekretit profesional dhe konfidencialitetit të të dhënave nga të gjithë përkthyesit e tjerë ose të punësuarit kur veprimtaria ushtrohet në një zyrë përkthimi.

#### Neni 11

### **Parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë**

Përkthyesi zyrtar ushtron profesionin e tij në respektim të parimit të barazisë dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi duke shmangur çdo formë mosdiskriminimi në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

#### Neni 12

### **Standardet e sjelljes profesionale**

1. Përkthyesi zyrtar shmang çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin dhe këtë Kod, si edhe ato veprime që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij profesionale dhe morale.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përkthyesi zyrtar zbaton rregullat e sjelljes, si më poshtë:

- a) sillet në çdo kohë në mënyrë të sjellshme dhe dinjitoze duke mbajtur një qëndrim korrekt dhe profesional;
- b) mban veshje formale dhe të përshtatshme;
- c) shmang përdorimin dhe paraqitjen pranë klientit dhe institucioneve publike në gjendje të mungesës ose të uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik ose mendor për shkak të konsumimit të alkoolit apo të substancave narkotike ose psikotrope;

c) shmang kryerjen e veprimeve ose gjesteve të pahijshme, përçmuese dhe ofenduese ndaj klientit dhe institucioneve publike që ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut për profesionin e përkthyesit zyrtar;

d) shfaq vetëpërmbajte në marrëdhënie me klientët, institucionet publike dhe të tretët edhe në rastet kur adresohen kritika ndaj veprimtarisë së tij.

#### Neni 13

### **Marrëdhënia me klientin dhe institucionet publike**

1. Në marrëdhënien me klientin dhe institucionet e tjera publike, përkthyesi zyrtar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për punën e kryer në përputhje me tarifat e miratuara, krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të nevojshme infrastrukturore për realizimin e përkthimit, si dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është rënë dakord në momentin e përzgjedhjes dhe kontraktimit të tij.

2. Detyrimet e përkthyesit ndaj klientit dhe institucioneve publike, janë:

- a) të informojë në mënyrë të plotë e të saktë mbi njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale;
- b) të respektojë solemnitetin e gjykimit;
- c) t'i përgjigjet në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar kërkesave që i paraqiten;
- ç) çdo detyrim tjetër për të cilin është rënë dakord në momentin e kontraktimit të tij, sipas përcaktimeve përkatëse ose që buron nga ky Kod.

#### Neni 14

### **Përdorimi i informacionit**

Përkthyesi zyrtar nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.

#### Neni 15

### **Marrëdhënia me kolegët**

1. Marrëdhëniet ndërmjet përkthyesve zyrtarë mbështeten në parimet e bashkëpunimit, ndershmërisë dhe solidaritetit profesional.

2. Përkthyesit zyrtarë mbështesin dhe mbrojnë interesat e profesionit, si dhe respektojnë e mbështesin kolegët e tyre duke reflektuar mirësjellje e qëndrime në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

3. Përkthyesi zyrtar nuk krahason apo komenton veprimtarinë dhe shërbimin e ofruar prej tij në raport me veprimtarinë dhe shërbimet e përkthyesve të tjerë, me përjashtim të rastit kur kjo kryhet në kuadër të shkëmbimit të përvojave, rritjes së standardeve profesionale dhe cilësisë së përkthimit, bashkëpunimit midis kolegëve dhe raportimit të shkeljes së parashikimeve të këtij Kodi.

4. Përkthyesi nuk bën asnjë veprim apo mosveprim, që nuk është në përputhje me reputacionin e profesionit për të marrë klientin e kolegut e tij ose që përbën shkak për konkurrencë të pandershme.

5. Kur midis përkthyesve zyrtarë lindin mosmarrëveshjeve në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit, bëhen të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre në mënyrë bashkëpunuese, konstruktive dhe profesionale.

#### Neni 16

### **E drejta për këshillim**

1. Çdo përkthyes zyrtar ka të drejtë të kërkojë nga Komisioni Disiplinor një opinion këshillimor për çështje të diskutueshme të zbatimit ose për përputhjen ose jo të një sjelljeje, veprimi apo mosveprimi të caktuar me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

2. Opinioni këshillimor i dhënë sipas pikës 1, të këtij neni, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e përkthyesit që e ka kërkuar atë në rast procedimi disiplinor. Ky opinion nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen e raste të tjera të ngjashme nga Komisioni Disiplinor.

#### Neni 17

#### **Shkelje disiplinore**

Moszbatimi ose shkelja, me veprime ose mosveprime, i parimeve të etikës dhe të sjelljes profesionale, të përcaktuara në këtë Kod, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore dhe merren masat disiplinore sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthimit zyrtar.

#### Neni 18

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kodi hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Kodi publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.